

Duaja është ibadet:

Duaja **????**(është prej llojeve më të rëndësishme të ibadetit, sepse i Dërguari i Allahut, Muhamedi r ka thënë: “Duaja është vetë ibadeti.”[\[1\]](#)

Po ashtu, Allahu i Madhërishëm thotë:

? ? ? ? ? ? ? ? ? ?

(Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos iu lutni askujt, krahas Allahut!)[\[2\]](#)

Llojet e duasë:**1. Dua që është ibadet (???? ?????):**

Me këtë nënkuptojmë çdo vepër me të cilën e adhuron njeriu Zotin e vet.

Këtu bëjnë pjesë: namazi, haxhi, sadakaja (lëmosha), agjërimi etj.

Cili është shkak i emërimit të këtyre veprave dua?

Këto vepra janë quajtur dua, sepse në to ekziston kuptimi i kërkesës, ngaqë kur i bën njeriu këto vepra sikur kërkon nga Allahu ta mëshirojë dhe ta fusë në Xhenet për shkak të tyre.

2. Dua që është kërkesë (???? ?????):

Kjo është kur duaja përmban në vete kërkesë.

Shembull: Thëniet “o Allah më mëshiro” dhe “o Zoti im, më fal”.

